



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMUNA E LIPJANIT

Në mbështetje të nenit 68 par 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 12 dhe 22 të Rregullores për kushtet, kriterët dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e dates 28.12.2016, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës bën këtë:

FTESË PUBLIKE PËR APLIKIM

FTOHEN, të gjitha klubet sportive të interesuara, të cilat zhvillojnë aktivitete e tyre sportive në Komunën e Lipjanit, se mund të aplikojnë me projektet e tyre për ndarje subvencioneve nga Komuna për vitin 2017.

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, :

1. Projekt propozimi;
2. Plani financiar
3. Certifikata e regjistrimit
4. Çertifikata e numrit fiskal
5. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së
6. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Komuna do të subvencionoj Klubet sportive në këto pozicione

1. Pagesën e Regjistrimit të Klubeve në Federatat Përkatëse
2. Pagesën e Kootizimit në Federatat Përkatëse
3. Pagesën e Referimit të ndeshjeve zyrtare të organizuara nga Federata Përkatëse
4. Pagesën e Transportit për ndeshjet zyrtare
5. Pagesën e Ushqimit për lojtarë dhe stafin e Klubit për të gjitha ndeshjet zyrtare
6. Rangu dhe kategoria në të cilën garon

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 3.

Aplikacionet e pakompletuara të paprecizuara, të panënshkrura nuk do të shqyrtohen.

Afati i fundit për aplikim është 15 ditë nga dita e shpalljes në Webfaqen e Komunës dhe në mediat lokale.

Nr. 1-111-7970
Lipjan më 27.02.2017

The seal is circular with the text "KOMUNA E LIPJANIT" around the top and "LIPJAN" at the bottom. In the center is a coat of arms.
KRYETARI I KOMUNËS
IMRI AHMETI
